



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 79, Datë 12.03.2026

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DEVOL HYDROPOWER” SH.A. PËR
KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË
ORIGINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR
HEC “MOGLICË” DHE HEC “BANJË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 660/1 prot., datë 11.03.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë DEVOL HYDROPOWER sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 80, datë 09.06.2016, nga HEC-et e kaskadës së lumit Devoll, përkatësisht për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”. Gjithashtu, kjo shoqëri është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.03.2015, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 36, datë 04.03.2015, i ndryshuar.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. me shkresën nr. 660 prot. datë 16.02.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”.
- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit HEC-eve përfshirë karakteristikat teknike të secilit prej tyre, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, si dhe të pikës së matjes.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se impiantet për të cilat kërkohet regjistrimi janë hidrocentrale me rezervuar, të cilët klasifikohen si impiante të përshtatshme për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
- Gjithashtu, nga informacioni i paraqitur rezulton se këto impiante nuk janë të pajisura me sistem pompimi kthyes, dhe për rrjedhojë nuk përjashtohen nga përfitimi i garancive të origjinës, në përputhje me nenin 22, pika 7 të ligjit nr. 24/2023.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI